



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
KOMISIONI I DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT

Nr. 20/1 Prot.

RHK

Kopje nr. 1 (një)

Tiranë, më 05.06.2018

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr.13, datë 03. 05. 2018, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë “deklasifikimin e plotë” të dosjes së klasifikuar “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 8 datë 05 . 06 .2018 si më poshtë:

1. Dosje e Problemit të Centralizuar nr.1079, me pseudonimin “Kubistët. Dosja ka 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dosje agjenturore nr. 181, me pseudonimin “Kubistët”. Dosja ka 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. Dosje perpersonale dhe pune nr. 12169, me pseudonimin “Pena”, për L.Ç. Dosja ka 38 (tridhjet e tetë) fletë, 25 (njëzet e pesë) fletë dhe 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Fotokopje e fletës së regjistrit të përpunimeve Model K.1 Tiranë, ku figuron i regjistruar F. L. me nr.regjistri 3204 në kategorinë 2A, me 1 (një) fletë.
4. Dosje formulare nr.1001, në ngarkim të S. M., kategoria 2 A. Dosja ka 120 (njëqind e njëzet) fletë dhe fashikull për të dënuarin S.M. ka 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
5. Dosje personale dhe pune nr.13854 e bashkpuntorit me pseudonimin “Motori” në ngarkim të A. A, me 19 (nëntëmbëdhjetë) dhe 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

**KRYETARI I KDZH**

*Gentiana Sula*

